

GJYKATA E APELIT

PRISHTINË

PAKR 487/13

13 shtator 2016

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit në kolegjin e përbërë nga gjyqtari EULEX-it, Piotr Bojarczuk, si kryetar i kolegjit dhe gjyqtar raportues, gjyqtari i EULEX-it Roman Raab dhe gjyqtari i Gjykatës së Apelit Xhevdet Abazi, si anëtar të kolegjit të ndihmuar nga Adnan Isufi, këshilltar ligjor i EULEX-it duke vepruar në cilësinë e procesmbajtësit në lëndën penale kundër:

I.T., emri i babait xxx, i lindur me xxx, në xxx, momentalisht jeton në xxx, xxx, xxx, xxx;

A. P., emri i babait xxx, e lindur me xxx, në xxx, momentalisht me vendbanim në xxx;

H.F. , emri i babait Nazif, i lindur me 24 prill 1964, në fshatin Zhabar, komuna e Mitrovicës, momentalisht me vendbanim në rrugën Edward Lear, nr. 33, Prishtinë.

I.H. , emri i babait Bajram, i lindur me 15 tetor 1959, në Sllatinë, momentalisht me vendbanim në rrugën Ali Ajeti, nr. 1, Podujevë.

Z.K. , emri i babait Musë, i lindur me 27 nëntor 1974 në komunën e Deçanit, momentalisht me vendbanim në Dardani SU 3/2, Prishtinë,

B.F. , emri i babait Muhamed, i lindur me 15 prill 1972, në Prishtinë, momentalisht me vendbanim në Prishtinë.

B.B. , emri i babait Sali, i lindur me 13 maj 1947, në komunën e Suharekës, momentalisht me vendbanim në rrugën Sharri, nr. 19, Prishtinë,

Të akuzuar në bazë të aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme PSRK), të datës 4 korrik 2012, e ndryshuar, për veprat penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar në kundërshtim me nenin 339 paragrafët 1 dhe 3, në lidhje me nenin 23 të KPK-së (të gjithë të pandehurit); Tentim i keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar në kundërshtim me nenin 339 paragrafët 1 dhe 3 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-së (**A.P.** dhe **I.T.**); Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare në kundërshtim me nenin 164 paragrafi 1, lidhur me nenin 23 (**I.T.** dhe **B.F.**); Marrja e ryshfetit në kundërshtim me nenin 343 paragrafi 2 të KPK (**I.H.** , **I.T.** dhe **H.F.**); Shmangia nga Tatimi në kundërshtim me nenin 249 paragrafi 2 të KPK (I.T.); Pengimi i të Provuarit në kundërshtim me nenin 249 paragrafi 2 të KPK (**I.T.**);

Pas pranimit të ankesës së PSRK-së të datës 16 gusht 2013 dhe ankesave të avokatëve mbrojtës, avokates Rrezarta Metaj në emër të **I.T.**t, të datës 7 gusht 2013, av. Naser Peci në emër të **A.P.**t, të datës 30 gusht 2013, av. Ramë Gashi në emër të **H.F.**, të datës 15 gusht 2012, dhe Parashtresat shtesë në Apel të paraqitura nga **I.T.** më 17 korrik 2013, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës P.nr 709/12, të datës 19 korrik 2013

Pas shqyrtimit të përgjigjeve të PSRK-së të datës 21 gusht 2013 dhe 30 gusht 2013, si dhe përgjigjeve të **I.T.**t të datës 4 shtator 2013, të **A.P.**t të datës 4 shtator 2013, përgjigjes së avokatit mbrojtës Osman Mehmeti në emër të **B.F.**t të datës 26 gusht 2013 dhe përgjigjes së avokatit mbrojtës Ramë Gashi në emër të **H.F.**.

pas shqyrtimit të Mendimit të Prokurorisë së Apelit të Kosovës të datës 27 shkurt 2014

pas këshillimit dhe votimit me 7 shtator 2016, me kërkesë të Prokurorit të Apelit për bashkimin e procedurës;

pas seancës publike të mbajtur më 27 shtator 2016 para Gjykatës së Apelit, dhe këshillimit të mbajtur më 13 shtator 2016,

Në përputhje me nenet 394, 401 dhe 402 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (më tej "KPP"), lëshon si më poshtë:

AKTGJYKIM

- I. Ankesa e PSRK-së e datës 16 gusht 2013 kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës P.nr 709/12, të datës 19 korrik 2013 kundër **I.T.t, A.P.t, H.F., I.H. t, Z.K. t, B.F.dhe B.B. t**, është pranuar pjesërisht.
- II. Aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës Themelore të Prishtinës P.nr 709/12, i datës 19 korrik 2013 anulohet në lidhje me pikat 1.1, 1.2, 1.3, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 2, 3.1, 10 dhe 12 dhe lidhur me këto pika lënda kthehet në rigjykim.
- III. Aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës Themelore të Prishtinës P.nr 709/12, i datës 19 korrik 2013, vërtetohet në lidhje me pikat 1.4, 1.5, 11 dhe edhe pikat në vijim të cilat nuk ishin ankimuar nga prokurori: 1.7, 1.10, 1.11, 1.12 , 1.13, 3.2, 6, 8 dhe 9.
- IV. Ankesa e PSRK-së e datës 16 gusht 2013 kundër Urdhrit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, e identifikueshme me numrin 302-2 / 08 e datës 29 prill 2008 është jorelevante.
- V. Ankesa e avokatit mbrojtës, av. Ramë Gashi në emër të **H.F.**, e datës 15 gusht 2012, refuzohet si e pabazuar.
- VI. Ankesa e avokatit mbrojtës, av. Rrezarta Metaj në emër të **I.T.t**, e datës 7 gusht 2013, në lidhje me pikën 9, është e pabazuar. Pjesa tjetër e ankesës nuk është relevante.

- VII. Ankesa e av. Naser Peci në emër të **A.P.t**, e datës 30 gusht 2013, dhe Parashtrësia shtesë në Apel e paraqitur nga **I.T.** më 17 korrik 2013, nuk janë relevante.

ARSYETIM

I. Historiati procedural

1. Më 4 korrik 2012, PSRK ka ngritur aktakuzën kundër të pandehurve të lartpërmendur dhe tre individëve, përkatësisht N. Sh., A. Th. dhe B. A., të cilët nuk janë objekt i kësaj procedure.
2. Të pandehurit në këtë procedurë ishin akuzuar se kinse kanë kryer veprat penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar në kundërshtim me nenin 339 paragrafët 1 dhe 3, në lidhje me nenin 23 të KPK-së (të gjithë të pandehurit); Tentim i keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar në kundërshtim me nenin 339 paragrafët 1 dhe 3 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK (**A.P.** dhe **I.T.**); Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare në kundërshtim me nenin 164 paragrafi 1, lidhur me nenin 23 (**I.T.** dhe **B.F.**); Marrja e ryshfetit në kundërshtim me nenin 343 paragrafi 2 i KPK-së (**I.H.** , **I.T.** dhe **H.F.**); Shmangia nga Tatimi në kundërshtim me nenin 249 paragrafi 2 i KPK-së (**I.T.**).
3. Aktakuza ishte ndryshuar disa herë; me 14 korrik 2012 për të përfshirë një rast shtesë të një pale të dëmtuar, A. R.; me 09 gusht 2012 në lidhje me të akuzuarin B.A. dhe A. Th. dhe me 6 mars 2013 në lidhje me të akuzuarin **B.B.** , **I.T.** dhe **H.F.** .
4. Më 03 shtator 2012 dhe më 05 shtator 2012, gjatë zhvillimit të seancave të konfirmimit, PSRK-ja ka tërhequr akuzat e Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar kundër të akuzuarit B.A.dhe akuzën e Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar (nën pikën 1.1

, 1.6, 1.7) dhe Keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike (në pikën 4) kundër të akuzuarit I.H.

5. Më 08 tetor 2012, Gjyqtari për konfirmim hodhi poshtë akuzën e Keqpërdorimit të pozitës zyrtare nga neni 339 par. 1 dhe 3 i KPK-së dhe kishte ndërprerë procedurën kundër B.A.
6. Më 8 shkurt 2013, Gjykata Themelore e Prishtinës ka veçuar procedurën penale kundër N. Sh. dhe I. A Në të njëjtën ditë, procedurat u veçuan edhe kundër A. Th.
7. Më 21 shkurt 2013, PSRK-ja tërhoqi verbalisht akuzën kundër A. Th.
8. Më 28 shkurt 2013, Gjykata Themelore e Prishtinës me aktgjykim hodhi poshtë akuzën kundër A. Th.
9. Më 19 korrik 2013, Gjykata Themelore e Prishtinës me aktgjykim e liroi N. Sh. nga vepra penale e Keqpërdorimit të pozitës zyrtare nga neni 339 par. 1 dhe 3 i KPK-së.
10. Më 19 korrik 2013, Gjykata Themelore e Prishtinës nxorri aktgjykimin e saj në lidhje me **I.T.n, A.P.n, H. F., I.H. n, Z.K. n, B. F. dhe B.B. n.** Gjykata Themelore shpalli:
 - **I.T.n** fajtor se dyshohet të ketë kryer veprën penale të shmangies nga tatimi (pika 9 e aktakuzës), në kundërshtim me nenin 313 të KPK-së dhe nxitje për të falsifikuar dokumente zyrtare në bashkë-kryerje (pika 1.3 e aktakuzës siç është ricilësuar nga kolegji) në kundërshtim me nenin 348 të lexuar me nenin 23 dhe nenin 23 të KPK-së. Në përputhje me nenin 80 të KPRK-së, gjykata i shqiptoi të pandehurit një dënim unik prej tetëmbëdhjetë (18) muaj burgim dhe një gjobë në vlerë prej një mijë (1.000) euro të paguhet brenda një periudhe prej dy (2) viteve

nga data kur aktgjykimi merr formën e prerë. Sipas nenit 54 të KPRK-së, të pandehurit iu shqiptua një dënim plotësues i ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik në një periudhë prej tri (3) viteve. Ai u lirua nga të gjitha akuzat e tjera.

- **A.P.**n fajtores se dyshohet të ketë kryer veprën penale të nxitjes për të falsifikuar dokumente zyrtare (pika 1.6 e aktakuzës siç është ri-cilësuar nga kolegji) në kundërshtim me nenin 348 të lexuar me nenin 24 të KPK dhe nxitje për të falsifikuar dokumente zyrtare (pika 1.6 e aktakuzës siç është ri-cilësuar nga kolegji) në kundërshtim me nenin 348 të lexuar me nenin 23 dhe nenin 23 të KPK-së. Në bazë të nenit 71 në lidhje me nenin 52 të KPRK-së, gjykata i shqiptoi të pandehurit një dënim unik me kusht prej tetë (8) muajve për një periudhë prej dy (2) viteve nga momenti kur aktgjykimi merr formën e prerë. Në bazë të nenit 54 në lidhje me nenin 56 të KPRK-së, të pandehurit iu shqiptua një dënim plotësues i ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik në një periudhë prej dy (2) viteve. Ajo u lirua nga të gjitha akuzat e tjera.
- **H.F.** fajtor se dyshohet të ketë kryer dy pika për pranimin e ryshfetit (pika 8.2 dhe 8.3 e aktakuzës), në kundërshtim me nenin 343 par. 2 i KPK-së. Në bazë të nenit 71 në lidhje me nenin 52 të KPRK-së, gjykata i shqiptoi të pandehurit një dënim unik prej tetë (8) muajve burgim. Në përputhje me nenin 54 të KPRK-së, të pandehurit iu shqiptua një dënim plotësues i ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik në një periudhë prej tri (3) viteve. Ai u lirua nga të gjitha akuzat e tjera.

11. **I.H.** , **B.B.** , **B.F.** dhe **Z.K.** janë liruar nga të gjitha akuzat.

12. Më 19 korrik 2013, me një Aktgjykim të veçantë, Gjykata Themelore e Prishtinës ka liruar I.A. nga të gjitha akuzat.

II. ANKESAT

13. Ankesa e prokurores së PSRK-së , znjsh. Maria Bamieh, kundër aktgjykimit të datës 19 korrik 2013 ishte paraqitur brenda afatit të përcaktuar ligjor.

14. Avokatët e mëposhtëm mbrojtës kanë paraqitur ankesat kundër aktgjykimit të datës 19 korrik 2013 brenda afatit të përcaktuar ligjor :

- Av.Rrezarta Metaj në emër të I.T.t.
- Av. Naser Peci në emër të A.P.t.
- Av. Rame Gashi në emër të H.F..

15. Ankesa e PSRK-së

Me 16 gusht 2013, PSKR e kundërshtoi lirimimin e:

- 1) I.T.t nga pikat 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 1.10, 1.11, pika 2, pikat 3.2, pika 10 dhe pika 12;
- 2) A.P.n nga pikat 1.1, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 dhe pika 2;
- 3) Hajrullah Fejzën nga pikat 1.9, 1.11 dhe 1.12;
- 4) Z.K. t nga pikat 1.9 dhe 1.10;
- 5) B.F.nga pika 1.9 dhe pika 3.2;
- 6) B.B. n nga pika 1.7, 1.8 dhe 11.

- PSRK-ja bazon ankesën e vet në shkeljen esenciale të procedurës penale (neni 384 par 1 nënpar 1.7 dhe 1.12 të KPP-së) dhe në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike (neni 383 (1.3) në lidhje me nenin 386 të KPP-së); dhe kundërshton vendimin mbi sanksionin penal të shqiptuar kundër I.T.t për dënime në lidhje me pikën 1.3 dhe pikën 9, për A.P.n për

dënimet në lidhje me pikat 1.3 dhe 1.6 dhe për Hajrullah Fejzën për dënime në lidhje me pikat 8.2 dhe 8.3.

- PSRK-ja kundërshtoi aktvendimin e gjykatës që i deklaroi të papranueshme provat e mbledhura në bazë të urdhrave të prokurorit PP nr. 328-2 / 08.

- PSRK-ja ka propozuar ndryshimin e aktgjykimit: të dënohen të pandehurit dhe të deklarohen provat e marra me urdhër të prokurorit si të pranueshme, dhe dënime të shqiptuara të mbeten të njëjta apo të rriten. Në alternativë, PSRK-ja propozon që lënda të kthehet në rigjykim tërësisht ose pjesërisht.

Në mënyrë të veçantë, prokurori deklaroi se gjykata ka dështuar që të përcaktojë plotësisht gjendjen faktike dhe të gjykojë plotësisht lëndën e akuzave (neni 386 dhe neni 385 par. 1 nënpar 1.7 i KPP-së), dhe të shpjegojë se pse prova e caktuar nuk ishte marrë në konsideratë (neni 384 par 1 subpar 1.12). Prokurori deklaroi si më poshtë:

Pika 1.1

Aktgjykimi është në kundërshtim me veten. A.P. dhe I.T. kanë lejuar një kontratë të lidhur ligjërisht me Jona Med me 26 shtator 2006, e cila i shkaktoj buxhetit të Kosovës një humbje prej mbi 1.5 milion euro. Gjykata pranoi se A.P. kishte për detyrë të kërkojë furnizime por gjykata nuk arriti të krijojë lidhjen mes dështimit të saj dhe mospërmbushjes pasuese të kontratës. I.T. mori detyrën më 9 gusht të vitit 2007 dhe ai ishte i informuar për këtë problem të paktën nga një kërkesë të cilën Jona Med ia kishte drejtuar atij drejtpërdrejt me 11 shtator 2007. Tolaj dëshmoi më 24 maj 2013, dhe ai mendonte se dëmi që duhet t'i paguhet Jona Med për mospërmbushjen e kontratës do të ishte maksimum 200.000 Euro dhe ka pranuar se ai nuk ka dashur të gjej një zgjidhje për shkak se ai ishte i gatshëm të paguajë këtë shumë nga buxheti i Kosovës. Dëshmitarja Fatime Aliu më 22 mars 2013 ka konfirmuar se Tolaj nuk ka qenë i interesuar që të gjej zgjidhje për këtë rast. Si rezultat i mospërmbushjes së kontratës, dy tenderë emergjent janë shpallur në dhjetor të vitit 2007, të cilët më vonë iu kishin dhënë kandidatit të favorizuar nga Tolaj.

Pika 1.2.

Gjykata ka gabuar në lirimin e A.P.t dhe I.T.t duke deklaruar se akti akuzues nuk përbën veprë penale. Nëse gjykata nuk ka gjetur prova të mjaftueshme për një verdikt të fajësisë, kjo nuk do të thotë se akuza nuk përbën veprë penale. Provat e paraqitura nga Alban Pozhegu janë të besueshme dhe të kuptueshme. Dëshmia e tij është e mjaftueshme për të vërtetuar akuzën. Pozhegu dëshmoi se Tolaj ka qenë i pranishëm gjatë dy vlerësimeve dhe ka udhëzuar kush të zgjedhej. Prania e Tolaj është konfirmuar edhe nga I.H. . Siç është pohuar nga Agim Zeqiri më 11 prill 2013, prania e Tolaj gjatë vlerësimit ishte vet një ndikim i papërshtatshëm. Gjykata nuk ka marrë parasysh as kontaktet mes Tolajt dhe Pajazitit dhe fituesit Burim Shkodrës, as lidhjet financiare dhe sociale ndërmjet Pajazitit dhe Burim Shkodrës. Fakti se oferta e ofruar nga Shkodra ishte më e lirë nuk ka ndonjë ndikim në këtë sjellje penale pasi që nuk duhet të ketë asnjë konflikt interesi *në vetvete*. Çmimi i ofertës ka mund të ketë qenë më i lirë për shkak se Tolaj dhe Pajaziti kanë mundur t'a kenë informuar atë në lidhje me ofertat e të tjerëve.

Pika 1.3

Sipas prokurorit, më 11 prill 2013 Agim Sheqiri kishte shpjeguar se tenderi duhej të anulohet dhe të rishpallej pasi Raimonda Hyseni nuk ka marrë pjesë në procesin e vlerësimit. Pajaziti dhe Tolaj i kanë thënë Hysenit, duke përfituar nga fakti se ajo ishte një punëtore e re pa përvojë në tenderim, për të nënshkruar formularët e vlerësimit për të parandaluar ri-shpalljen e tenderit dhe humbjen e përfitimit material për kompanitë të cilat e kishin fituar tenderin. Gjykata e cilësoi këtë sjellje si nxitje për të falsifikuar dokumentet zyrtare. Prokuroria paraqet se gjykata duhet të kishte konfirmuar veprën penale të Keqpërdorimit të detyrës dhe duke mos vepruar kështu kolegji e ka kundërshtuar vetveten. Të dy të pandehurit kanë vepruar në cilësinë e tyre zyrtare duke vënë presion mbi Raimonda Hysenin që të nënshkruaj dokumentet duke e ditur se ajo nuk kishte marrë pjesë në vlerësimin e atij tenderi. Nga përkufizimi një sjellje e tillë i tejkalon kufijtë e kompetencave që i bashkëngjiten pozitës zyrtare dhe duhet të cilësohet si keqpërdorim i detyrës.

Pika 1.4.

A.P. dhe I.T. kanë pranuar se kanë pirë kafe me Burim Shkodrën në dhjetor të vitit 2007, gjatë kohës kur grupi i parë i tenderëve ishte shpallur nën menaxhimin e Tolajt. Qëllimi i vetëm ishte për të lidhur kontratë të panevojshme në mes të zyrtarit të Ministrisë dhe operatorëve ekonomikë.

Pika 1.5

A.P. ka pasur një interes në kompaninë e cila ishte në pronësi të vëllait të Burim Shkodrës. Ajo ka marrë një pagë prej asaj kompanie. Prandaj, i gjithë procesi i vlerësimit të tenderit është ndikuar sepse ajo nuk ka qenë e paanshme gjatë dhënies së tenderit të dytë emergjent Burim Shkodrës.

Pika 1.6 background

A.P. ka tejkalluar detyrat e saj duke sugjeruar përdorimin e skemës së garancisë bankare. Skema ishte krejtësisht e paligjshme. Pajaziti dhe Tolaj janë marrë vesh që ta përdorin atë. Pajaziti ka udhëzuar komisionin pranues që të nënshkruajnë që kanë marrë mallrat të cilat ende nuk ishin dorëzuar. Tolaj ka lejuar që kjo të ndodhë. Nëse gjykata nuk ishte bindur për keqpërdorim të detyrës, kjo sigurisht që është një mashtrim. Gjykata kishte fuqinë për të ri-cilësuar faktet. Tolaj është akuzuar për miratimin e këtij vendimi.

Pika 1.7 dhe 1.8.

Të pandehurit kanë keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare duke udhëhequr një fushatë për të dëmtuar Jona Med. Tolaj në një intervistë e cila ishte transmetuar në gjithë Kosovën e kishte quajtur Jona Med-in një kompani e kontrabandës dhe e kishte akuzuar atë për krim të organizuar. Gjykata kishte dështuar të vlerësojë deklaratat e dëshmitarëve Ekrem Maliqi, Alban Pozhegu, Haxhi Kamberi dhe Berat Marmullahu të cilët të gjithë thanë se Tolaj nuk e donte Jona Medin dhe ai nuk do të nënshkruante kontrata apo të aprovonte tenderët që ata i kishin fituar. Gjykata ka konstatuar se shumë dëshmitarë kanë deklaruar se Tolaj kishte shumë ndikim mbi B.B. n, por nuk ka arritur të shpjegojë se pse këto dëshmi nuk janë të mbështetura nga gjykata. Gjykata flet në lidhje me "akuzat", por në këtë rast nuk ka akuza, ekzistojnë prova të drejtpërdrejta që janë ofruar në formën e deklaratave të dëshmitarëve. B.B. nuk ka nënshkruar kontrata dhe nuk ka dhënë asnjë arsye për këtë. Pasi që në kontrata mungonte nënshkrimi i tij, ato janë konsideruar si

kontrata që nuk janë vazhduar. Gjykata ka konstatuar nga provat e dhëna nga Faton Çitaku, Alberta Grantolli, Haxhi Kamberi dhe Ekrrem Maliqi se ministri ka pasur takime me kompanitë kontratat e të cilëve duhej të vazhdoreshin. Gjykata ka konstatuar se ekziston një lidhje në mes të mosvazhdimin dhe bisedave në mes të Bukoshit dhe përfaqësuesve të kompanive të cilat nuk e kishin fituar vazhdimin e kontratës. Gjykata megjithatë ka dështuar për të krijuar një lidhje në mes të takimeve ku përfaqësuesit e kompanive ishin marrur në pyetje në lidhje me paditë që ata i kishin deklaruar kundër Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe pasojat e mos-vazhdimin të kontratave të tyre, pa asnjë lloj justifikimi. Gjykata gjithashtu ka dështuar që të marrë në konsideratë dëshmitë e ekspertit Agim Sheqiri i cili ka deklaruar se kontratat *një plus një* ishin të reja, dhe se në rast të mos-vazhdimin, duhet të ketë qenë ndonjë shpjegim me shkrim pse kontratat nuk janë vazhduar. Gjykata nuk arrit të marrë në konsideratë deklaratën e dëshmitarit Haxhi Kamberi i cili ia dha kontratat z. Bukoshi për nënshkrim. Gjykata nuk ka dhënë asnjë arsyetim se pse Bukoshi është i besueshëm në krahasim me të gjithë dëshmitarët Agim Sheqiri, Haxhi Kamberi, Ekrem Maliqi, Faton Çitaku dhe Alberta Grantolli, të cilët të gjithë vërtetuan njëri-tjetrin, ndërkohë që nuk ka pasur asgjë për të vërtetuar apo për të mbështetur shpjegimin e z. Bukoshi.

Pika 1.9

Shpjegimi i fakteve nga Berat Marmullaku është i qëndrueshëm, i kuptueshëm dhe i besueshëm. Konstatimi i gjykatës se "ai së pari tha se e kishte gjetur vlerësimin e parë në zyrën e Z.K. t dhe më vonë kishte pranuar se ai e kishte marrë atë nga dosja e bën deklaratën e tij më pak të besueshme", duket të jetë një konstatim qartazi i gabueshëm i gjendjes faktike. Më 21 shkurt 2013, ai e sqaroi këtë mospërputhje. Prokurori citon "*Kur kam thënë në deklaratën time të datës 11 janar 2012 se unë nuk isha në posedim të këtij raporti, por e gjeta atë kur Z.K. ishte në pushim vjetor, unë iu kam referuar një rasti krejtësisht tjetër i cili nuk ka të bëjë asgjë me Llotin 20*". Më tej, deklarata e Marmullakut është vërtetuar nga ekzistenca e dy raporteve të vlerësimit: njëra e datës 28 mars 2011 e cila e kishte zgjedhur Jona Medin si fitues, dhe deklaratën tjetër të datës 15 prill 2011, e cila shpalli Liri Medin si fitues. Të dy, Fusha dhe Fejza, thanë se një tjetër vlerësim ishte bërë në muajin prill. Ekziston edhe një e-mail i cili i ishte dërguar Fushës dhe Marmullakut më 14 prill nga Fejza duke theksuar se cilat kompani duhet të diskualifikohen. Të gjithë të dyshuarit kanë pranuar se i kanë nënshkruar dy formularë të vlerësimit dhe që kanë qenë nënshkrimet e tyre në formularët e vlerësimit të datës 28 mars 2013. Siç shpjegohet nga Agim

Sheqiri me siguri ka qenë vetëm një formular i vlerësimit. Eksperti i prokurimit ka dëshmuar se kur kryeshefi nuk pajtohet me raportin e vlerësimit, ai ka të drejtë të thërras një komision tjetër për të kryer një vlerësim tjetër. Kuqi ka zgjedhur që të bind kolegët e tij për të bërë një vlerësim tjetër të dokumenteve. Gjykata ka pranuar se fijet e kërkuara për qepje të plagëve ishin të pranishme në katalogun Demetech (katalogu i Jona Medit) dhe se katalogu i Liri Medit paraqiste produkte të ngjashme, të cilat mund të jenë të këmbyeshme. Një procedurë e tenderit nuk parashikon mundësinë për të zgjedhur produkte të cilat janë të këmbyeshme. Pasi që Gjykata ka pranuar se Demetech kishte fijet e kërkuara për qepje të plagëve, ndërsa katalogu i Braunit nuk i kishte, Gjykata është dashur të ketë pyetur se si u bë që Liri Med kishte fituar dhe Jona Med kishte humbur në këto rrethana pasi që ata kishin prodhimet e njëjta të cilat ishin 1.5 milionë euro më të lira.

Pika 1.10

Gjykata ka konstatuar në mënyrë të drejtë faktet që theksojnë numrin e tenderëve të Ministrisë së Shëndetësisë të publikuar dhe të anuluar për Fludarabine dhe Beta Interferon, por ka dështuar që të përcaktojë përgjegjësinë e I.T.t, Z.K. t dhe Bekim Fushës. Kompania Sante Pharm e cila e kishte humbur tenderin ishte e vetmja që e kishte licencën për të sjellë në Kosovë ilaçin në fjalë. Eksperti i prokurimit ka shpjeguar se në qoftë se është vetëm një kompani e cila mund të sjellë një produkt të nevojshëm, atëherë ligji parasheh procesin e drejtpërdrejtë të negociatave e cila përjashton një proces të tenderit publik. Deklarata e Ekrem Maliqit është vërtetuar nga deklarata e Milaim Abdullahut. Ekrem Maliqi ia ka thënë këtë informacion Abdullahut se në kohën kur kanë ndodhur ngjarjet, asnjëri prej tyre nuk e ka ditur në atë kohë që kjo bisedë do të bëhej një provë. Gjykata tregon mungesën e konsistencës dhe koherencës me pranimin e deklaratave të Curr Gjocajt dhe Besim Bajraktarit rreth bisedës që ata e patën me Lubeniqin menjëherë pas takimit të Lubeniqit me Fejzën, por nuk e pranon deklaratën e Abdullahut në lidhje me informacionin që ai e kishte marrë nga Ekrem Maliqi në kohën kur kishin ndodhur ngjarjet. Nuk ka pasur asnjë shpjegim se pse dy deklaratat e dëshmitarëve janë trajtuar në mënyrë aq të ndryshme.

Pika 1.11

Prokurori deklaroi se nuk ka asnjë shpjegim tjetër logjik për mosvazhdimin e kontratës në mes të Ministrisë dhe Fadil Lubeniqit për furnizimin me pika intravenoze përpos faktit që z. Lubeniqi kishte refuzuar që t'i paguaj ryshfet H.F.. Kjo është akuza për të cilën Gjykata e kishte dënuar Hajrullah Fejzën nën pikën 8. Argumenti i prokurorisë i bazuar në deklaratat e Fadil Lubeniqit dhe Ekrem Maliqit është se edhe pse I.T. ka nënshkruar kontratën me Fadil Lubeniqin, ai ia kishte dhënë tenderin për të njëjtin produkt furnizuesit më të shtrenjtë, sepse ai e dinte se kontrata me Fadil Lubeniqin nuk do të vazhdohej.

Pika 2

Gjykata ka konstatuar si fakt që Bekim Deshishkut iu kishte ofruar një tender me vlerë prej 70.000 euro në këmbim të tërheqjes së padisë. Bekim Deshishku ka qenë shumë i qartë se Arbenita ia kishte bërë këtë ofertë. Faton Çitaku e kishte kuptuar këtë informacion nga Bekimi menjëherë pas ngjarjeve dhe e kishte konfirmuar këtë. Gjykata ka dështuar që të ofrojë arsye pse deklaratat e Bekim Deshishkut, Faton Cetiakit dhe Ekrem Maliqit nuk janë të besueshme dhe janë të pamjaftueshme për të provuar përgjegjësinë penale të I.T.t dhe A.P.t nën pikën 2.

Pika 3.2

Lidhur me këtë pikë, d.m.th Keqtrajtimin e Berat Marmullakut, gjykata nuk i ka marrë parasysh shpjegimet e Berat Marmullaku se pse gjatë deklaratës të tij të dhënë më 5 janar 2012 ai e kishte mohuar se kishte pasur kërcënime. Gjatë dëshmisë së tij më 21 shkurt 2013, ai i konfirmoi kërcënimet. B.F. i tha Berat Marmullakut "për shkak teje më duhet të shkojë në prokurori, ti me ke shkaktuar dëm".

Pika 10

Prokurori i referohet ekstrakteve të përgjimeve të cilat janë administruar gjatë gjykimit për të vërtetuar akuzën. Biseda në mes të Ilirit dhe Imerit tregon se dëshmitari është kontaktuar dhe "neutralizuar". I.T. ishte i gatshëm të paguaj. Biseda tregon një plan për përpjekje për të ndikuar ekspertët. Kjo është një dëshmi e qartë e pengimit të provave. Më tej, Tolaj ka udhëzuar Albulena Mehmetin çfarë duhet t'i jepet zyrtarëve hetues dhe çfarë duhet të pengohet. Në lidhje

me këto biseda që tregojnë përpjekjen për të ndikuar hetimin, prokuroria deklaroi se gjykata ka gabuar në ligj duke kërkuar dëshmitarët aktual që ishin penguar.

Pika 11

I.T. dëshmoi se pas arrestimit të tij dhe lirimit me dorëzani, ai ka folur me ministrin Bukoshi dhe të dy vendosën se është më mirë që të mos veprojnë më si këshilltar i tij personal në mënyrë që Ministri të mos i ekspozohet kritikave të panevojshme. Zëvendës kryeministri i tha Bukoshit se çështja e ri-caktimit së z. Tolaj duhet të trajtohet nga Kryeministri. Bukoshi thjesht nuk e ka pasur autoritetin për t'u marrë me këtë çështje, por ai e bëri këtë në kundërshtim me ligjin për shërbimin civil. Ai e ka shpërfillur urdhrin nga eprori i tij dhe i ka tejkaluar kompetencat e autoritetit të tij duke e ri-caktuar Tolajn në pozitën e tij si Sekretar i Përhershëm.

Pika 12

Ekrem Maliqi u hoq nga pozita e tij menjëherë pas takimit me Tolajn, sepse Maliqi kishte refuzuar të nënshkruajë vlerësimin e tenderit. Vlerësimi i tenderit ishte nënshkruar nga Z.K. i cili ishte emëruar si ushtrues detyre i drejtorit të Prokurimit në të njëjtën ditë që Maliqi u shkarkua. Eksperti i prokurimit dëshmoi se kur zyrtarët e lartë urdhërojnë menaxherin e prokurimit për të nënshkruar një formular vlerësimi, atëherë duhet të jepet një arsytim me shkrim. Gjykata dështoi të vlerësojë provat kontradiktore që vërtetojnë deklaratën e Ekrem Maliqit d.m.th.e pranimin e kërkesës nga I.T. për nënshkrim të përbashkët me Ekrem Maliqin.

16. Ankesa kundër aktvendimit për shpalljen e rezultateve të regjistrimit të thirrjeve telefonike të marra përmes urdhër të prokurorit 328-2 / 8 të datës 28 prill 2008 si të papranueshme.

Prokurori deklaroi se aktvendimi është i pranueshëm për shkak se prokurori kishte juridiksion për të nxjerrë urdhra të tilla; aktvendimi i inicimit të hetimeve nuk ka qenë kusht dhe nuk ka asnjë dispozitë e cila nuk i parasheh si të papranueshme provat e siguruar para aktvendimit për fillimin e hetimeve.

17. Përgjigjet në Ankesa:

- I.T. pohon se Aktakuza nuk i plotëson kërkesat ligjore, dhe kështu gjykata nuk kishte asnjë zgjidhje tjetër përpos të lirojë të akuzuarit. Ai pohon se zyrtarët e Ministrisë kanë shpenzuar buxhetin për furnizimin me ilaçe tashmë në vitin 2006, para se ai të merrte një pozitë në Ministri për buxhetin e vitit 2007. Ai i referohet deklaratave të hapjes dhe mbylljes dhe ankesës së tij dhe propozon që ankesa e prokurorit të refuzohet si e pabazuar në të gjitha bazat.

- Avokati Naser Peci paraqet si një vërejtje të përgjithshme se aktakuza nuk i plotëson kërkesat ligjore. Ai thekson se papranueshmëria e provave të marra nëpërmjet urdhrat të prokurorisë ishte shpallur me aktvendimin e gjykatës i cili në mungesë të ankesës mori formën e prerë. Nuk ka asnjë bazë ligjore për ta kundërshtuar atë. Në lidhje me pikat e veçanta në ankesë, avokati paraqet kundër argumente duke pretenduar se ankesa është e pabazuar.

- Avokati Ramë Gashi paraqet kundër-argumente në lidhje me pikën 1.9 dhe pikën 2.

- Avokati Osman Mehmeti pohon se prokurori ka dështuar që të përshkruajë elementet e veprave penale në aktakuzë, jep vlerësimin për besueshmërinë e dëshmitarit Berat Marmullaku, dhe konkludon se ankesa e prokurorit lidhur me të dy pikat është e pabazuar.

ANKESAT E AVOKATËVE MBROJTËS:

18. Më 7 gusht 2013, av. Rrezarta Metaj në emër të I.T.t ka kundërshtuar dënimin e Tolajt për pikën 1.3 dhe pikën 9. Ajo e bazon ankesën e saj në të gjitha bazat ligjore të përcaktuara në nenin 383 par. 1 të KPP-së. Ajo propozon ndryshimin e aktgjykimit të shkallës së parë dhe lirin e I.T.t nga këto akuza apo anulimin e pjeshëm të aktgjykimit që ka të bëjë me dënimin e të akuzuarit ose që të shqiptohet një dënim më i butë.

Lidhur me pikën 1.3 të aktakuzës, avokatja deklaron:

- Kryerësja e krimit të pretenduar të përcaktuar në nenin 348 ishte Rajmonda Hyseni e cila dyshohet se është nxitur nga Tolaj dhe A.P.. Ky krim është "delicta propria" që mund të kryhet

nga një kategori e caktuar e kryerësve- zyrtarë (në sektorin publik) ose persona përgjegjës (me lidhje me dokumentet e biznesit). Gjykata nuk arriti të vërtetojë se Raimonda Hyseni ishte person zyrtar në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe se formularët e vlerësimit në fjalë janë dokumente zyrtare.

- Asnjë nga format e kryerjes së krimit nuk ishte materializuar në rast, sepse Raimonda Hyseni me nënshkrimin e saj konfirmoi një përmbajtje e cila nuk ishte false dhe vlerësimi i ofertuesve ishte bërë në përputhje me ligjin.

- Nxitja nuk mund të ekzistojë në mënyrë të pavarur; kjo varet nga ekzistenca e veprës së theksuar. Rajmonda Hyseni nuk është ndjekur penalisht për kryerjen e asnjë krimi e as që ka qenë dëshmitare bashkëpunuese.

- Elementet subjektive nuk janë plotësuar. Gjykata nuk i ka vendosur kufijtë e qëllimit dhe aq më pak nuk e ka bërë vlerësimin e ndonjë prove lidhur me këtë.

- Nuk është përcaktuar nëse i pandehuri e dinte se Rajmonda Hyseni nuk ka marrë pjesë në procesin e vlerësimit për të arritur një përfundim të tillë që ai kërkoi nga ajo që të nënshkruajë formularin e vlerësimit.

- Aktgjykimi tejkaloi kufijtë e aktakuzës në kundërshtim me nenin 360 (1) të KPP-së. Avokati mbrojtës deklaroi se elementet e veprës penale të falsifikimit të dokumenteve zyrtare nuk janë përfshirë në aktakuzë dhe gjykata me shtimin e fjalisë "Raimonda Hyseni e ka nënshkruar formularin e vlerësimit" e ka kryer përshkrimin e veprës.

- Shkelje e nenit 370 (7) të KPP-së, pasi gjykata nuk arriti të deklarojë në mënyrë koncize se cilat fakte relevante të cilat çuan në dënim ishin konsideruar si të vërtetuara dhe cila ishte baza për një përfundim të tillë.

- Aktgjykimi nuk mund të kundërshtohet në mënyrë të duhur dhe efikase në bazë të përcaktimit të fakteve nëse nuk ka asnjë krahasim të provave kundërshtuese.

- Akuzat në pikën 1.3 nuk janë vërtetuar dhe gjykata është dashur që të aplikojë parimin "*in dubio pro reo*".

- Nga formulimi i aktgjykimit mund të konkludohet se i pandehuri dhe A.P. personalisht dhe gjithashtu nëpërmjet Alban Pozhegut kishin kërkuar nga Rajmonda Hyseni që të nënshkruaj dokumentin. Megjithatë, përveç Alban Pozhegut i cili i ndryshonte deklaratat e tij gjatë tërë procedurës, dëshmitarët e tjerë dhe të bashkë-pandehurit e konfirmuan se askush nuk e kishte dëgjuar I.T.n ti kishte thënë ndonjë gjë Rajmonda Hysenit apo Alban Pozhegut sa i përket nënshkrimit të dokumenteve të vlerësimit.

- Alban Pozhegu qartazi ishte nën presion nga policia dhe nga prokurori. Ai tha se I.T. i kishte dhënë atij urdhra për të nënshkruar faturat e falsifikuara në lidhje me çështjen e garancive bankare por I.T. ishte liruar nga kjo.

- Rajmonda Hyseni dëshmoi se ka qenë Pozhegu ai i cili ka kërkuar nga ajo që të nënshkruajë formularin e vlerësimit.

Lidhur me pikën 9 të aktakuzës mbrojtja deklaron:

- Është e vërtetë se I.T. ka pranuar pagesa nga Zvicra në këste të ndryshme në shumën e përgjithshme prej 13,689.85 euro, për të cilat ai nuk ka paguar tatimet.

- Elementet subjektive të shmangies nga tatimi mungojnë në dispozitiv të aktgjykimit. Qëllimi për të shmangur pagesën e tatimeve i cili është një element konstituiv i kësaj vepre dhe që e bën dallimin në mes të shkeljes administrative të mos-deklarimit të të gjitha tatimeve dhe veprës penale për shmangie nga tatimi siç perceptohet në ligjin penal nuk është vërtetuar.

- Gjetjet në lidhje me parashkrimin për këtë vepër të veçantë penale janë ligjërisht të gabueshme. I pandehuri kishte një obligim që të deklarojë tatimet në vitin 2008 dhe mos deklarimi i tij ka ndodhur më 1 prill 2009. Aktakuza është ngritur pasi që periudha e parashkrimit relativ tanimë kishte kaluar. Pasi që afati absolut është gjashtë vjet atëherë të gjitha ngjarjet që kanë ndodhur para datës 19 korrik 2007 konsiderohet se nuk mund të ndiqen nga prokuroria.

- Aktgjykimi tejkalon përshkrimin e veprave që janë të përfshira në pikën 9 të aktakuzës, në kundërshtim me nenin 384 (1) pika 10 e KPP-së.

- Të gjitha të hyrat dhe të gjitha transaksionet në llogaritë e tij bankare ishin krejtësisht transparente. Kjo vërteton dëshminë e tij se ai nuk kishte absolutisht asnjë qëllim për t'iu

shmangur pagesës së tatimit. Nuk është ndërmarrë asnjë veprim për të mashtruar administratën apo për të fshehur ndonjë pagesë.

- I pandehuri ka vepruar me pakujdesi dhe ai e ka pranuar gabimin që e ka bërë. Nuk ka pasur asnjë dëm të përhershëm pasi që pandehuri i ka shlyer të gjitha tatimet në buxhetin e shtetit një vit pas lëshimit të fundit për të deklaruar tatimet.

- Dënimet individuale dhe dënimi unik nuk janë në proporcion.

- Parandalimi i përgjithshëm ka mbizotëruar jashtë mase mbi rrethanat individuale si dhe mbi parimin e kufizimit të represionit të ligjit penal, njerëzimit, risocializimit dhe rehabilitimit.

- Nuk ka asnjë arsye për t'i shqiptuar dënim plotësues për ndalimin e ushtrimit të funksioneve të shërbimeve publike.

19. Më 30 gusht 2013, av. Naser Peci në emër të A.P.t, paraqiti një ankesë. Ai e kundërshtoi aktgjykimin në bazë të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ai propozon ndryshimin e aktgjykimit për lirimin e të akuzuarit nga akuzat sipas pikës 1.3 dhe 1.6 të dispozitivit.

Avokati mbrojtës deklaron:

- Se nuk ka prova për të vërtetuar nxitjen qoftë me deklaratë verbale, urdhër me shkrim, premtim, kërcënim ose në ndonjë mënyrë tjetër, e cila do të kishte ndikuar ndonjë anëtar të Komisionit Vlerësues.

- Nuk ka asnjë provë që vërteton se dokumenti i vlerësimit ose pranimi i mallrave ka qenë një dokument zyrtar sipas nenit 120 par. 1 pika 2 e KPK-së.

- Nuk mundet të qëndrojë fakti që iniciuesi i dyshuar të thirret në përgjegjësi penale ndërsa ai që e ka kryer këtë veprim të jetë dëshmitar.

- Përfundimi i gjykatës se "zonjusha Raimonda Hyseni nuk ka pasur përvojë të mjaftueshme në Ministri për shkak se ajo sapo kishte filluar të punojë aty" nuk qëndron, sepse ajo ka qenë duke punuar për Ministrinë që nga viti 2001. Dëshmitari Agim Sheqiri ka deklaruar "nuk ka pasur rëndësi nëse të gjithë anëtarët e komisionit kishin njohuri për procedurën e prokurimit. Ka qenë e mjaftueshme nëse ata kanë pasur njohuri profesionale për çështjen e cila ishte duke u vlerësuar, për shkak se ajo ishte kryer nga zyrtarët e prokurimit".

- Dëshmitarja Rajmonda Hyseni përjashton çdo pretendim se zonjusha A.P. kishte ndikuar në të për të nënshkruar dokumentet e vlerësimit.

- Dëshmitarët Ekrem Maliqi (Drejtor i Zyrës së Prokurimit) dhe Agim Sheqiri (Ekspert i Prokurimit) ka shpjeguar rolin e komisionit të vlerësimit, i cili dëshmon se gjykata ka gabuar në përfundimin se Rajmonda Hyseni ishte nxitur nga A.P. për të nënshkruar raportin e vlerësimit për tenderin 7130007737126 .

- Dëshmitari Lutfi Mulaku ka dhënë shpjegim të detajuar në lidhje me skemën e garancisë bankare, ndërsa dëshmitari Haki Ejupi ka konfirmuar se procedurat e pranimi të mallrave nuk kanë qenë në kompetencë të zonjushës A.P., por ishte një detyrë e Drejtorit të Departamentit Farmaceutik.

- Dëshmitari Alban Pozhegu nuk është i besueshëm. Ai ka pohuar se dikush i kishte thënë (ai nuk ka mund të konfirmojë se ka qenë zonjusha A.P.) që dokumentet që lidhen me garancitë bankare janë në rregull.

-Dëshmitarja Nyrtene Zeqiri ka konfirmuar se ajo kishte marrë udhëzime nga zyrtarët e Departamentit Farmaceutik për të nënshkruar faturat e garancive bankare. Nyrtene Zeqiri ka nënshkruar të gjitha faturat lidhur me rastet e Medisan Commerce, Liri Med, Koslabor apo Miditrade në të cilat A.P. nuk ka qenë pjesë e komisionit për pranim. Nuk ka prova që të vërtetojnë se A.P. ka nxitur ose iu ka thënë anëtarëve të komisionit për pranimin e mallrave të nënshkruajnë formularët e pranimi.

20. Më 15 gusht 2013, Av. Ramë Gashi në emër të H.F. e bazon ankesën e tij në shkeljen e dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, sanksionit dhe gjithashtu në

masën për ndalimin nga ushtrimi i funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik. Avokati propozon ndryshimin e aktgjyimit të shkallës së parë dhe lirim të H.F. nga këto akuza ose të anulojë aktgjykimin dhe të kthejë çështjen për rigjykim.

Avokati deklaron:

- Se në pikën 8.2 aktgjykimi thotë "në një datë të pacaktuar në vitin 2011 i kishin thënë Milaim Avdullahut se ai duhet të jap një pjesë prej 10%, nëse ai don që të merr një kontratë me Ministrinë e Shëndetësisë". Kjo nuk mbështetet nga asnjë provë. Z. Avdullahu nuk e përmend fare shumën 10%, por i referohet si "një sasi të caktuar të parave".

- Z. Avdullahu deklaroi se ai ishte i ftuar në një takim me z. Fejza, por nuk ka prova për të vërtetuar këtë deklaratë.

- Z. Avdullahu mohon të ketë thirrur z. Fejza; megjithatë, raporti i Policisë së Kosovës i datës 16 mars 2012 mbi përgjimin e SMS-ve tregon se zoti Avdullahu e kishte thirrur për një takim dhe kafe.

- Z. Avdullahu e kishte fituar tenderin edhe pse ai nuk kishte pranuar që të japë ryshfet siç pretendohet.

- Dëshmitari Fadil Lubeniqi nuk është i besueshëm. Ai mohoi se kishte ngritur padi kundër Ministrisë së Shëndetësisë; megjithatë ai e kishte paraqitur një padi. Z. Lubeniqi ka deklaruar se ai ishte ftuar disa herë nga z. Fejza dhe disa herë nga miqtë e tij z. Marko Markovic dhe z. Xhevdet Matoshi. Megjithatë, më vonë ai kishte mohuar të ketë marrë ndonjë letër ose tekst nga z. Fejza për ti thënë z. Lubeniqi që të shkojë në Ministri.

- Z. Besim Bajraktari mohon t'i ketë thënë z. Lubeniqi që të shkojë lart pasi që me siguri e kanë thirrë për kontratë dhe do të kërkojnë t'iu japësh para.

- Z. Curr Gjoci gjithashtu nuk është i besueshëm. Ai pretendon të mos e mbaj mend emrin e Lubeniqit edhe pse në fakt ata janë miq të mirë.

- Z. Curri dhe Bajrakari deklarojnë që Lubeniqi ishte në posedim të regjistrimit por Lubeniqi mohon se ka pasur ndonjë regjistrim.
- Lubeniqi ka konfirmuar se ka takuar z. Ekrem Maliqi, por z. Maliqi në deklaratën e tij ka thënë se ai kurrë nuk ka biseduar me z. Lubeniqi për të diskutuar në lidhje me kontratën.
- Z. Lubeniqi deklaron se atyre iu kishte kërkuar ryshfet në nëntor, ndërsa në Gjykatën Ekonomike ai pohon se ka qenë në dhjetor.
- Z. Lubeniqi ka deklaruar para prokurorit dhe gjykatës se se ai ka pasur një fitim prej 40.000, 00 euro ndërsa në kërkesën e tij për kompensim, ai ka kërkuar më shumë se një milion euro.

21. Përgjigjet e PSRK-së në ankesat e avokatëve mbrojtës

Prokurori i EULEX-it në PSRK ishte përgjigjur se ankesat e mbrojtësve e kanë shtyrë gjykatën që t'i refuzojë ato si të pabazuara.

22. Mendimi i Prokurorisë së Apelit

- Më 6 mars 2014, Prokurori i Apelit ka paraqitur në Gjykatën e Apelit mendimin e tij të datës 27 shkurt 2014.
- Prokurori i Apelit *inter alia* ka kërkuar bashkimin e procedurës kundër Imer Ajetit me procedurat kundër Tolajt dhe të pandehurve të tjerë. Prokurori pohon se kushtet e përcaktuara në nenin 35, paragrafët 3 dhe 5-8 të KPP-së janë plotësuar pasi që rasti i të bashkë- pandehurit I.T. është në procedurën ankimore në Gjykatën e Apelit dhe rasti i Imer Ajetit i përdorë provat e I.T.t.
- Si pikënisje Prokurori i Apelit përmend kundërshtimet në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 11 prill të vitit 2013 të paraqitur nga PSRK-ja më 27 nëntor 2013 dhe kërkon nga Gjykata që të marrë procesverbalin e papërmirësuar nga procesmbajtësit për të kontrolluar saktësinë e provave të ofruara nga dëshmitari ekspert, Agim Sheqiri.

- Prokurori i Apelit paraqet se aktgjykimi i lëshuar më 14 qershor 2013 nuk i përshkruan në mënyrë të plotë akuzat në dispozitivin e tij e cila është një kërkesë e nenit 370 paragrafët 3 dhe 4 të KPP-së. Prokurori deklaron se gjykata dështoi të flas për shkeljen e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë (Ligji nr. 2003/17) në lidhje me pikat 1.4, 1.5, 1.9; për të përshkruar dobinë dhe dëmin si pasojë e krimit në lidhje me pikat 1.11,1.13 dhe pikën 2; të përshkruaj në pikën 3.2 kërcënimin që Berat Marmullaku e kishte marrë nga i akuzuari që i ishte bërë atij për shkak se ai ishte pajtuar të dëshmojë në rastin PPS 64/11; nuk ofron përshkrimin e akteve në pikën 6; në pikën 11 ofron një përshkrim të veprimeve me të cilat B.B. nuk ishte i akuzuar ndërsa hesht për aktet me të cilat ai ishte akuzuar dhe në pikën e 12 ai hesht për aktin plotësues të I.T.t lidhur me keqpërdorimin e pozitës së tij gjatë largimit të Ekrem Maliqit nga pozita e tij.
- Prokurori i Apelit konstaton se ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384 par. 1 nënpar 1.12 të KPP-së. Mangësia e dispozitivit në lidhje me akuzën 11 dhe 12, veçanërisht kur konsiderohet së bashku me mungesën e arsytimit parasheh që gjykata nuk ka gjykuar plotësisht lëndën e akuzës.
 - Prokurori i Apelit mbështet argumentet e paraqitura në ankesën e PSRK-së se gjykata nuk ka ofruar asnjë vlerësim të provave në arsyetimin e aktgjykimit të saj që përbën një shkelje të nenit 370 paragrafi 7 i KPP-së. Në mënyrë të veçantë, në pikën 1.12 gjykata i referohet deklaratës së dëshmitarit Alban Pozhegu dhe thekson se ajo nuk mbështetet nga deklarata e të akuzuarës A.P.t. Prokurori i Apelit deklaron se e sheh përpjekjen e gjykatës si të palogjikshme për të kërkuar mbështetje për deklaratën e një dëshmitari- që dëshmon nën obligimin për të treguar të vërtetën- në deklaratën e të akuzuarit- i cili nuk është i obliguar për të treguar të vërtetën-ose në dokumentet e tenderit të korruptuar, siç pretendohet nga prokuroria. Prokurori i Apelit pohon se arsyetimi i aktgjykimit nuk flet për vlerësimin se pse Gjykata e gjeti deklaratën e A.P.t më të besueshme sesa deklaratën e dëshmitarit Alban Pozhegu.
 - Në pikën 1.3, gjersa gjykata konstatoi përgjegjësinë penale për veprën penale të Falsifikimit të Dokumenteve Zyrtare duke e shtyrë Raimonda Hysenin që të nënshkruajë

vendime për vlerësimin e tenderit në të cilën ajo nuk kishte marrë pjesë, gjykata hesht lidhur me konkluzionin në vështrim të parë jo logjik për lirimin e I.T.t dhe A.P.t nga Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar.

- Gjkata nuk arriti të vlerësojë provat dhe sjelljen e të akuzuarit në pikat 1.4 dhe 1.5 kundër situatës ligjore dhe të sigurojë një vlerësim të plotë për këto akuza në bazë të nenit 5 dhe 6 të Kodit të Prokurimit të Etikës të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik të Kosovës.

- Në pikën 2, gjykata nuk arriti të bashkëngjës ndonjë arsyetim për lirimin e I.H. t në pajtim me nenin 370 të KPP-së, edhe pse kjo nuk është kundërshtuar nga PSRK-ja, ndërsa arsyetimi në pikën 8 është shumë i mangët në lidhje me dënimin e H.F..

- Prokurori i Apelit mbështet argumentet e paraqitura në ankesën e PSRK-së se B.B. në njëren anë ka shkelur ligjin duke e emëruar I.T.n si sekretar i përhershëm pavarësisht këshillës që iu kishte dhënë atij nga zëvendës Kryeministri se çështja duhet të vendoset nga Kryeministri, dhe në anën tjetër e ka shpërfillur nenin 69 të Ligjit për Shërbimin Civil.

- Nuk ka asnjë arsyetim në lidhje me dënimin e shqiptuar për I.T.n, A.P.n dhe Hajrullah Fejzën për të justifikuar konstatimet e gjykatës në lidhje me nenin 52 par. 4 të KPRK-së, dhe nuk është bashkëngjitur asnjë arsyetim në vendimin mbi shpenzimet e procedurës.

- Arsyetimi i aktgjykimit është dukshëm kundërthënës në lidhje me arsyet e lirimit. Për më tepër, prokurori deklaroi se mund të vërehet një pasiguri absolute e ligjit material në fuqi në tërë dispozitivin dhe arsyetimin e aktgjykimit me lidhje me dënimet e të akuzuarve.

- Prokurori i Apelit deklaroi se ekziston një mospërputhje thelbësore në mes të urdhrin origjinal të Prokurorit Publik në gjuhën shqipe dhe përkthimit të tij në gjuhën angleze e cila ka pasur një efekt negativ në aktvendimin e gjyqtarit për konfirmim. Versioni shqip i

urdhrit thotë se prokurori publik ka kërkuar vetëm regjistrin, dmth. regjistrimet e thirrjeve hyrëse dhe dalëse telefonike dhe mesazheve tekstuale të bëra për të dhe nga numrat e dhënë të telefonit të A.P.t dhe të tjerëve gjatë kohës së dhënë. Prokurori publik nuk ka kërkuar zbulimin e përmbajtjes së këtyre telekomunikimeve. Prokurori i Apelit deklaron se gjyqtari për konfirmim nuk ka vendosur për kërkesën e avokatit mbrojtës në lidhje me rezultatet e regjistrimeve dhe vendimi i saj është i kufizuar në përjashtimin e përgjimit të thirrjeve telefonike, duke përfshirë leximin e mesazheve tekstuale nga provat. Për më tepër, Prokurori i Apelit pohon se më 11 prill 2013, kolegji nuk ka vendosur mbi pranueshmërinë e rezultateve të regjistrimit të marra në bazë të urdhrit PP nr. 302-2 / 08 të prokurorit publik por më tepër ka interpretuar aktvendimin dhe në këtë mënyrë ka ardhur deri tek përfundimi i gabuar se në bazë të këtij aktvendimi edhe rezultatet e regjistrimit duhet të përjashtohen nga provat. Për këtë arsye, prokurori deklaron se rezultatet e regjistrimit nuk është dashur të jenë përjashtuar nga provat.

- Prokurori i apelit është i mendimit se ankesat e PSRK-së kundër aktgjykimeve janë pjesërisht të bazuara pasi që ato lidhen me shkeljet thelbësore të procedurës penale dhe të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike. Prokurori i apelit megjithatë nuk ka mendim të njëjtë lidhur me propozimin e PSRK-së mbi mjetet juridike.
- Duke iu referuar ankesës së mbrojtësit, Prokurori i Apelit konstaton se ankesa është vetëm pjesërisht e bazuar gjersa i referohet shkeljes esenciale të procedurës penale në lidhje me pikën 1.3. Pjesa tjetër e ankesës është pa merita.
- Prokurori i apelit propozon që të pranohet pjesërisht ankesa e PSRK-së dhe ankesa e avokates mbrojtëse Rrezarta Metaj dhe duke vepruar *sipas detyrës zyrtare* në lidhje me pikën e 8-H.F. pjesërisht të anulohen aktgjykimet e Gjykatës Themelore, përveç për veprat penale të cilat janë të prekura nga parashkrimi, dhe ta kthej çështjen në Gjykatën Themelore për rigjykim në përputhje me nenin 402 paragrafët 1 dhe 3 të KPP-së; të shqyrtojë ex officio, nëse vepra penale për nxitje për falsifikim të dokumenteve zyrtare nën pikën 1.3 kundër I.T.t dhe A.P.t dhe pika 1.6 kundër A.P.t bie nën nenin 91 par. 6 të KPK-së që përjashton në mënyrë absolute ndjekjen penale; për të refuzuar ankesat e

avokatëve mbrojtës Naser Pecit dhe Ramë Gashi si të pabazuara dhe të vërtetojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore me lidhje me dënimin e I.T.t për veprën penale të shmangies nga tatimi (pika 9) dhe në pjesët e mbetura.

III. Procedurat para Gjykatës së Apelit

23. Kolegji i Gjykatës së Apelit është i përbërë në pajtim me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me mandatin e Misionit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës (Nr. 04 / L-273) dhe gjithashtu në përputhje me marrëveshjen ndërmjet shefit të EULEX-it dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës në aspektet relevante të aktivitetit dhe bashkëpunimit të gjyqtarëve të EULEX-it me gjyqtarët e Kosovës që punojnë në gjykatat vendore e cila ishte arritur me 18 qershor 2014.
24. Kolegji thekson se, sipas legjislacionit të mësipërm, kur një rast i është caktuar gjyqtarëve të EULEX-it para datës 15 prill 2014 atëherë, rasti konsiderohet si një rast në vazhdimësi. Kjo do të thotë se rasti do të vazhdojë të trajtohet nga gjyqtarët e EULEX-it në përputhje me ligjin që ishte në fuqi në kohën kur rasti iu kishte caktuar gjyqtarëve të EULEX-it. Ndryshimet pasuese në ligj, siç është rasti këtu, sipas mendimit të kolegjit, nuk mund të kenë fuqi prapavepruese në lidhje me përbërjen e kolegjit pa marrë parasysh në çfarë faze të procedurës është ai rast i veçantë.
25. Kolegji thekson se nuk ka pasur kundërshtime nga ndonjë palë në procedurë në lidhje me përbërjen e kolegjit me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it. Prandaj, Kolegji konkludon se procedura në lidhje me përbërjen e trupit gjykues nuk ka pësuar ndryshim nga amandamentet në legjislacion.
26. Më 7 shtator 2016, kolegji refuzoi propozimin për bashkimin e procedurave kundër rastit Tolaj me procedurën kundër Imer Ajetit. Kolegji konstaton se kriteret e nenit 35 të KPP-së për bashkim në gjykatën e shkallës së dytë nuk janë përmbushur plotësisht.
27. Kolegji thekson se aktiviteti kriminal, siç është paraqitur nga Prokuroria në të dyja rastet, edhe pse i ngjashëm, është në thelb i natyrës së ndryshme. Kolegji për këtë arsye nuk

është i kënaqur se aktet e përshkruara në aktakuzë kundër Imer Ajetit dhe në aktakuzën kundër të tjerëve janë të ndërlidhura në kuptimin e nenit 35, paragrafi 6 i KPP-së. Të dy procedurat ishin zhvilluar në mënyrë të ndarë në shkallë të parë. Kjo tregon se të pandehurit nuk ishin të pranishëm në të dy rastet përkatëse. Si pasojë, ata nuk kanë pasur mundësi që të kundërshtojnë provat dhe të shprehin pikëpamjet e tyre në lidhje me provat e administruara në procedurat e ndryshme.

28. Kolegji është i mendimit se përfitimi sa i përket drejtësisë, efikasitetit, dhe mbrojtjes së interesave të drejtësisë është me rëndësi të madhe që të zhvillohen të dy rastet veç e veç. Nuk ka asnjë arsye për të dyshuar ndonjë vonesë, kosto shtesë financiare etj për shkak të zhvillimit të dy procedurave veç e veç.

IV. Pranueshmëria e ankesave :

29. Në mënyrë që të gjykohen meritat e ankesave, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse, janë plotësuar kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara në KPP. Për këtë qëllim, Kolegji ka vendosur:

- a. Ankesat janë të pranueshme. Ato janë paraqitur në gjykatën kompetente në pajtim me nenin 388 par. 1 dhe brenda afatit në pajtim me nenin 380 par 1 të KPP-së.
- b. Gjykata e Apelit ka vendosur në seancë siç është përshkruar në nenin 390 të KPP-së. Në përputhje me nenin 392 të KPP-së nuk ka qenë e nevojshme të mbahet shqyrtim.

V. Gjetjet e Gjykatës së Apelit

30. Gjykata shqyrtoi të gjitha provat e paraqitura qoftë ato që janë paraqitur nga avokatët, të pandehurit, prokurori ose nga burime të tjera, ose të cilat janë marrur *proprio motu*.

31. Përderisa arsyet për të vendosur në favor të ankesave të paraqitura ekzistojnë edhe për të pandehurit e tjerë të cilët nuk kanë paraqitur një kërkesë të tillë, Gjykata ka vendosur sikur ata të kishin paraqitur një ankesë të tillë. (*Beneficium Cohesionis*).
32. Kolegji konstaton se ankesa e PSRK-së është pjesërisht e bazuar. Aktgjykimi i ankimuar, për sa i përket pikave të cilat janë referuar për rigjykim, është i bazuar në shkeljen e dispozitave të procedurës penale (neni 383 par 1.1) dhe një vlerësim i pasaktë dhe jo i plotë i provave me zbatimin e nënkuptuar të pasaktë të ligjit material (neni 383 par 1.3 dhe 383 par 1.2 të KPP-së).
33. Në arritjen e këtij vendimi, kolegji ka marrë parasysh mospërputhjet e shumta në mes të dispozitivit dhe arsytimit në aktgjykimin e kundërshtuar dhe mospërputhjet në dëshmitë inkriminuese në të cilat është mbështetur gjykata më e ulët. Sipas mendimit të Kolegjit serioziteti i shkeljeve nuk lejon që të ndryshohet aktgjykimi në lidhje me pikat për rigjykim. Prandaj, është vendosur që aktgjykimi të priset pjesërisht dhe lënda të kthehet në rigjykim, në pajtim me nenin 398 par 1.3 të KPP-së.
34. Në mënyrë që të ofrohen udhëzime për rigjykim, Gjykata e Apelit zgjodhi që të adresojë pikat e zgjedhura të ligjit, të cilat mund të jenë të rëndësishme në procedurën e rigjykimit; këto diskutohen më poshtë.
35. Neni 370 i KPP-së përcakton përmbajtjen dhe formën e aktgjykimit të shkruar. Struktura e secilit aktgjykim është e përbërë nga tri komponente kryesore: hyrja, dispozitivi dhe arsyetimi. Në lidhje me përmbajtjen dhe formën, kodi nuk bën asnjë dallim në mes të llojeve të ndryshme të aktgjykimeve. Kështu, pavarësisht nëse një aktgjykim është shfajësues, refuzues apo fajësues, ai duhet të përmbajë të gjitha faktet vendimtare dhe rrethanat që përbëjnë apo jo elementet e veprës penale dhe ato mbi të cilat varet zbatimi i një dispozite të veçantë të Kodit Penal.
36. Kolegji gjen kundërthënie flagrante në mes të dispozitivit dhe arsytimit të aktgjykimit në lidhje me pikat që janë kthyer për rigjykim. Për këtë arsye, aktgjykimi i kundërshtuar është i pakuptueshëm, në brendësi jo i saktë ose në kundërshtim me arsyetimin e

aktgjykimit dhe nuk përmend arsyet lidhur me faktet vendimtare në kundërshtim me nenin 370 të KPP-së.

37. Gjykata e shkallës së parë e ka liruar A.P.n dhe I.T.n për shkak se "me veprimin e tyre të përbashkët si zyrtar për furnizim respektivisht si sekretar i përhershëm në Ministrinë e Shëndetësisë në mes të datës 26 shtator 2007 dhe 1 tetor 2007, kanë lejuar që të skadojë një kontratë ligjërishit e detyrueshme me Jona Medin me datë 26 shtator 2006 pa i respektuar termet dhe kushtet e saj"(pika 1.1)¹. Në arsyetim, gjykata ka vërtetuar detyrën e A.P.t për të kërkuar furnizime². Sa i takon Tolajt, gjykata ka vërtetuar se ai është informuar për këtë problemin dhe nuk ka gjetur zgjidhje. Më saktë, gjykata gjen se "Me" 11 gusht/shtator 2007 Jonamed kishte kërkuar takim me I.T. si sekretar permanent pasi që kontrata nuk ishte përmbushur dhe tenderi ishte ri-shpallur"³.
38. Kolegji konstaton se të gjeturat e gjykatës së shkallës së parë janë kundërthënëse me vetën në lidhje me pikën 1.1. Ky kolegji gjen disa kundërthënie ndërmjet dispozitivit dhe arsyesimit. Në njërin anë, gjykata e shkallës së parë vërteton dështimin e Arbenitës për të kërkuar furnizime kurse në anët nuk e shpjegon lidhjen ndërmjet dështimit dhe mospërmbushjes së kontratës. Gjykata ka treguar se prokurori nuk ka provuar mospërmbushjen e kontratës si pasojë e mosveprimit të Pajaziti, as nuk ka dhënë vlerësim tjetër për ndonjë provë. Gjykata e shkallës së parë bie në kundërshtim me vetën edhe për kohën angazhimit të I.T.t si sekretar permanent në Ministrinë e Shëndetësisë. Në dispozitiv nuk ka ndonjë provë për kohën e angazhimit si sekretar permanent në Ministrinë e Shëndetësisë. Në arsyetim, përveç se tregohet se I.T. nuk ka punuar për Ministrinë e Shëndetësisë në periudhën gusht-shtator 2007⁴, nuk jepet shpjegim se a ka kontribuar Tolaj a jo në mospërmbushjen e kontratës me Jonamed. Gjatë gjykimit janë dëgjuar një numër i dëshmitarëve. Në Aktgjykimi nuk tregohet se kush ka dhënë dëshmi dhe kush cka ka thënë. Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës shihet se Fatime Aliu ka dëshmuar se e ka informuar bordin e drejtorëve dhe Tolajn për padinë dhe rrezikun që Ministria mund të

¹ Aktgjykimi i shkallës së parë, faqe 2

²² Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, faqe 2

³ Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, faqe 2

⁴ Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, faqe 2

obligohet të paguaj kompensim. Edhe Arben Loshi ka dëshmuar për rastet e mëhershme kur kontrata ishin vazhduar përtej afateve. Ndërmjet Ministrisë dhe Yess Pharm është nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi që ka mundësuar përmbushjen e kontratës përtej datës së skadimit. Aktgjykimi jo vetëm që nuk ka një analizë të deklaratave të dëshmitarëve por as nuk flet për versionin e të pandehurve për ngjarjet. Dihet qartë se Tolaj ishte informuar për problemin. Ai ka deklaruar se ka menduar që kompensimi për mospërmbushjen e kontratës me Jonamed nuk do të tejkalonte shumën e 200.000 €. Për këtë arsye kolegji nxjerrë konkluzionin se gjykata e shkallës së parë jo vetëm që nuk i ka vlerësuar si duhet deklaratat e dëshmitarëve, por as nuk ka dhënë shpjegime për deklaratat e të pandehurve.

39. Kolegji vëren se gjetjet e gjykatës së shkallës së parë janë në kundërshtim me vetën edhe për pikën 1.2 dhe 1.3. I.T. është liruar për pikën 1.2 se *“Në dhjetor 2007, u ka thënë komisioneve vlerësuese se cili operator duhej të zgjidhej për tenderët e emergjencës 71300007737126 dhe 7130007789126”*⁵. Gjykata e shkallës së parë në arsyetim ka vërtetuar se akti i supozuar kishte ndodhur me 30 nëntor 2007 dhe 27 dhjetor 2007⁶. Duke liruar Tolajn, gjykata ka vendosur se deklarata e Alban Pozhegut, i cili ka dëshmuar se I.T. i kishte thënë atij dhe A.P.t se cilat kompani duhej të shpallehin fitues, nuk është mbështetur me deklaratat e A.P.t⁷.

40. I.T. dhe A.P. janë shpallur fajtorë për pikën 1.3 se *“ me 7 dhjetor 2006 ata i kanë kërkuar Rajmonda Hysenit personalisht edhe përmes Alban Pozhegut të nënshkruaj se ka marrë pjesë në vlerësimin e tenderit 71300007737126 ndonëse nuk kishte marrë pjesë”*⁸. Gjykata ka ri-cilësuar veprën penale duke besuar se I.T. dhe A.P.n kanë kryer veprën penale nxitjes për Falsifikim të Dokumentit Zyrtar në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 348 lidhur me nenin 23 të KPK-së. Për tenderin tjetër 71300007789126 I.T. dhe A.P. janë liruar. Gjykata ka vendosur se nuk është vërtetuar që *“I.T. dhe Arbenita Pajziti me 27 dhjetor 2006 i kanë kërkuar Rajmonda Hysenit personalisht dhe nëpërmjet Alban*

⁵ Aktgjykimi I gjykatës e shkalles se pare, faqe 3

⁶ Aktgjykimi I gjykatës e shkalles se pare, faqe 13

⁷ Aktgjykimi I gjykatës e shkalles se pare, faqe13

⁸ Aktgjykimi I gjykatës e shkalles se pare, faqe 3

Pozhegut ta nënshkruaj se ajo ka marrë pjesë në vlerësimin e tenderit tjetër 71300007789126 ndonëse ajo nuk kishte marrë pjesë⁹”. Sipas gjykatës, nuk ka prova që mbështesin dëshminë e Alban Pozhegut pasi që Rajmonda Hyseni ka deklaruar se ai ka ardhur me dokument në zyrë e saj dhe nuk është paraqitur asnjë provë tjetër¹⁰.

41. Fillimisht, kolegji gjen se dilema e cekur në pikën 1.1 për kohën e angazhimit të I.T. si sekretar permanent në Ministrinë e Shëndetësisë vlen edhe për pikën 1.2 dhe 13. Nuk është dhënë shpjegim nëse I.T. ka punuar për Ministrinë e Shëndetësisë në periudhën në fjalë, gjegjësisht, gjatë vlerësimit të tenderëve të emergjencës 71300007737126 dhe 7130007789126. Kolegji e sheh tepër të nevojshme të thekson se mospërputhjet lidhur me kohën janë relevante sepse gjykata duket se e vënë ngjarjen e njëjtë në kohë të ndryshme, prandaj ngjallë dyshime mbi vërtetësinë e qasjes së saj lidhur me përfshirjen e Tolajt. Kolegji po ashtu konstaton se arsyetimi i aktgjykimit nuk jep asnjë vlerësim për besueshmërinë e provave kundërthënëse. Nuk është dhënë shpjegim se pse deklarata e Alban Pozhegut është trajtuar më ndryshe në dy tenderët tjerë të emergjencës, pra 71300007737126 dhe 7130007789126, kur të dy kanë ndodhur në rrethana gati identike. Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë ka vendosur se deklarata e Alban Pozhegut nuk është e besueshme në lidhje me tenderin 7130007789126 sepse nuk mbështetet me deklaratën e Arbenita Pajziti, pa analizuar gjithë dëshminë e tij dhe në kontekst të dëshmive të dëshmitarëve tjerë. Në këtë kontekst, kolegji e sheh të nevojshme të theksoj se fakti që versioni i dëshmitarit nuk vërtetohet nga deklarata e të pandehurit, në mungesë të provave tjera mbështetëse, nuk e bënë deklaratën e dëshmitarit të dyshimtë. Versioni i një të pandehuri a i një dëshmitari në cilindo procedurë mund të ketë kundërthënie me versionin e një të pandehuri a dëshmitari tjetër. Kjo pritet në çdo procedurë. Në çdo shkallë, gjykata duhet të shqyrtoj natyrën e kundërthënive si psh, a kanë të bëjnë me elementet faktike thelbësore apo sekondare, a janë a nuk janë të kuptueshme dhe a tregojnë apo jo, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat, mosvërtetësinë e qëllimshme të dëshmitarit. Pas analizës së hollësishme, gjykata ka obligim të shpjegoj cili version është i besueshëm, më i besueshëm apo deri në çmasë është i besueshëm. Në rastin në fjalë,

⁹ Aktgjykimi I gjykatës e shkallës së parë, faqe 3

¹⁰ Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, faqe 14

gjkata e shkallës së parë nuk ka dhënë asnjë vlerësim për deklaratat e dëshmitarit. Është e qartë se I.H. ka konfirmuar praninë e Tolajt në zyrën e Rajmonda Hysenit. Agim Sheqiri ka dëshmuar se vetë prania është një ndikim i tepërt. Agim Sheqiri ka shpjeguar se tenderi është dashur të anulohet dhe i gjithë procesi të përsëritet për shkak se Rajmonda Hyseni nuk ka marrë pjesë në procesin e vlerësimit. Kolegji bashkohet me mendimin e PSRK-së se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh as kontaktet e Tolajt dhe Pajazitit me fituesin, me lidhjet financiare dhe sociale që Pajaziti ka pasur me Burim Shkodrën. Nuk ka as vlerësim për të dhënat që rrjedhin nga masat e fshehta në këtë aspekt. Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë analizë të duhur të natyrës së bisedës, për konfliktin e mundshëm të interesit dhe mbi nivelin e ndikimit që ka mundur të ketë në këtë proces tenderues. Sipas kolegjit rrethanat e cekur sipër kërkojnë vlerësim të përgjithshëm të dëshmimeve të dëshmitarëve në aspektin e besueshmërisë së tyre, përveç vlerësimit në mënyrë të stërholluar për përputhshmërinë e brendshme dhe në lidhje me provat materiale që rrjedhin nga masat e fshehta.

42. Gjkata e shkallës së parë e ka vërtetuar përgjegjësinë penale të Tolajt dhe Pajazitit për veprën penale nxitje për falsifikim të dokumentit zyrtar (pika 1.3 dhe 1.6). Gjkata ka vendosur se Tolaj dhe Pajaziti kanë nxitur Rajmonda Hysenin t'i nënshkruaj vendimet mbi vlerësimin e tenderit në të cilat ajo nuk ka marrë pjesë (pika 1.3). Gjkata ka rikualifikuar veprën e Tolajt dhe Pajazitit si nxitje për falsifikim të dokumentit zyrtar. A.P. është shpallur fajtor edhe për nxitjen e një anëtari për pranimin e komisionit të nënshkruar një deklaratë të pranimit të barërave nga furnizuesit ndonëse mallrat nuk janë marrë (pika 1.6). Kolegjin konstaton se aktgjykimi i shkallës së parë nuk ka arsyetim adekuat për klasifikimin ligjor për veprën penale që i ngarkohet të akuzuarit në të dy pikat. Kolegji vëren se gjykata nuk ka shpjeguar nëse veprimi i Tolajt dhe i Pajazitit (pika 1.3), gjegjësisht, veprimi i Pajazitit (pika 1.6) ka pasur ndonjë lidhje me detyrën e tyre zyrtare dhe autorizimin. Nuk është dhënë shpjegim nëse sjelljet e të pandehurve përbëjnë tejkalim të kompetencave të parapara për një pozitë zyrtare, të cilat në fund mund të përbëjnë keqpërdorim të detyrës. Në anën tjetër, as elementet subjektive nuk janë vlerësuar fare. Gjkata nuk ka vërtetuar kufijtë e dashjes e lerë më vlerësimin e ndonjë prova në këtë aspekt. Në këtë rast, kolegji pajtohet me avokatin e Tolajt se për të ekzistuar

nxitja kërkohet të vërtetohet se personi i nxitur ka kryer veprë penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se personi i nxitur duhet domosdo të dënohet, përveç nëse ka baza për dënim. Në këtë rast, jo vetëm që gjykata nuk ka vërtetuar se Rajmonda Hyseni ka kryer ndonjë veprë penale edhe nëse lirohet nga përgjegjësia penale, por gjatë gjithë procedurës penale ajo është trajtuar si dëshmitare. Në rast se lënda kthehet në rigjykim, nuk është detyrë e këtij kolegji të bëjë ndonjë vlerësim për kualifikimin e akuzave. Megjithëkëtë, për hir të preventivës, kolegji e sheh të udhës të theksojë se kur një veprë penal shkel më shumë se një dispozitë ligjore të së drejtës materiale, gjykata duhet të marrë parasysh zbatimin e dispozitave që ndërlidhen me bashkimin ideal të krimeve.

43. Gjykata e ka liruar I.T.n dhe A.P.n nga akuza për veprat e cekura në 1.16 se *“në nëntor e dhjetor 2007 dhe kohës së përfaqësuar ata kanë pasur takime me furnizuesit në data të ndryshme ndërmjet 15 dhe 18 nëntorit dhe furnizuesit me ç ‘rast furnizuesve që nuk kanë mundur të bëjnë furnizime deri me 21 dhjetor 2007 u është kërkuar të sjellin garancione bankare”*¹¹. Po ashtu gjykata ka vërtetuar se Ministria e Shëndetësisë është dëmtuar sepse origjina e disa mallra të dorëzuar në fund nuk është përputhur me origjinën e përshkruar në ofertën e tenderit. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur se kjo nuk ka qenë pasojë e përdorimit të Garancioneve bankare por e neglizhencës së komisionit që ka pranuar këto mallra kur janë shpërndarë. Kolegji konstaton se gjykata nuk ka bërë vlerësim të provave. Veçanërisht në lidhje me deklaratat e Rajmonda Hyseni dhe Musa Rexhaj. Të dy këta kanë shpjeguar se dhënia e parave për ushqimin që nuk është pranuar është e kundërligjshme, kurse vënia e nënshkrimit se janë pranuar mallrat që në fakt nuk janë pranuar është mashtrim.

44. Kolegji konstaton se situata është e njëjtë përkitazi me pikat 1.7, 1.8, 1.10, 1.11, pikën 2, pikën 3.1, pikën 10 dhe pikën 12. Kolegji gjen se në pajtim me nenin 370 para 7 të KPK-së gjykata ka obligim të theksojë në mënyrë të qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte i konsideron të vërtetuara ose të pavërtetuara si edhe bazat. Gjykata ka detyrim, sidomos, të

¹¹ Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, faqe 4

bëj një vlerësim të besueshmërinë së provave kundërthënëse, bazave për mospranimin e propozimeve individuale të palëve dhe arsyet me të cilat gjykata ishte udhëhequr në zgjedhjen e çështjeve ligjore. Gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë vlerësim të kujdesshëm të secilës dëshmi të dëshmitarëve dhe të pandehurve veç e veç dhe në lidhje me njëri-tjetrin dhe të nxjerrë një përfundim se a është vërtetuar një fakt i dhënë apo jo. Sa i takon pikave në 1.7 dhe 1.8, gjykata nuk ka dhënë vlerësim për deklaratat e dëshmitarëve, Ekrem Maliqi, Alban Pozhegu, Haxhi Kamberi dhe Berat Marmullaku. Të gjithë këta kanë thënë se Tolajt nuk i ka pëlqyer Jona Med dhe ai nuk do t'ia nënshkruante kontratat as aprovonte tenderët që i kanë fituar. Shihet qartë se gjykata përmes provave të dhëna nga Faton Çitaku, Alberta Grantolli, Haxhi Kamberi dhe Ekrem Maliqi ka vërtetuar se Ministri është takuar me kompanitë që është dashur t'i vazhdojnë kontratat. B.B. nuk i ka nënshkruar kontratat. Nuk është bërë elaborim as për lidhjen ndërmjet takimeve në të cilat përfaqësuesit e kompanive janë pyetur për padinë kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe për pasojat e mosvazhdimin të kontratave të tyre. Po ashtu, kolegji nuk gjen as vlerësim të deklaratës së ekspertit Agim Sheqiri i cili ka thënë se kontratat një plus një ishin të reja dhe në rast të mosvazhdimin është dashur të jepet shpjegim me shkrim se pse kontrata nuk janë vazhduar.

45. Sa i takon pikës 1.9 gjykata nuk ka dhënë ndonjë analizë të deklaratës së Marmullakut e cila vërtetohet me ekzistencën e dy raporteve vlerësuese: njëri i datës 28 mars 2011 me të cilën Jona Med zgjidhet fitues, dhe tjetri i datës 15 prill 2011 me të cilin Liri Med shpallet fitues. Ashtu si ka thënë PSRK-ja, me çka kolegji pajtohet, edhe Fusha edhe Fejza kanë thënë se një vlerësim tjetër ishte bërë në prill. Me 14 prill Fejza u kishte dërguar Fushës dhe Marmullakut një e-mail duke cekur se cilat kompani duhej të diskualifikoheshin. Të gjithë të dyshuarit kanë pranuar se kanë nënshkruar dy formularë të vlerësimit. Nënshkrimi i tyre shihet në formularët e nënshkrimit të datës 28 mars 2013. Agim Sheqiri ka shpjeguar se është dashur të kishte vetëm një formë vlerësimi. Eksperti i prokurimit ka dëshmuar nëse zyrtari kryesor nuk pajtohet me raportin vlerësues, ka të drejtë të ftojë një komision tjetër për të bërë vlerësim tjetër.

46. Për pikën 1.10, është e qartë nga shkresat e lëndës së Sante Pharm Company që e ka humbur ofertën është e vetmja kompani që ka pasur leje për të sjellë penj kirurgjik në Kosovë. Eksperti i prokurimit ka shpjeguar se nëse ka vetëm një kompani që mund të sjellë një produkt të nevojshëm, atëherë ligji parasheh proces të negociatave të drejtpërdrejta me çka përjashtohet procesi i tenderit publik. Nuk ka vlerësim të deklaratës së Ekrem Maliqit ose Milaim Abdullahut në lidhje me deklaratat e Curr Gjocajt dhe Besim Bajraktarit për bisedën që kanë pasur me Lubeniqin menjëherë pas takimit të Lubeniqit me Fejzën.
47. Për pikën 1.11, kolegji nuk ka gjetur asnjë shpjegim për mosvazhdimin e kontratës ndërmjet Ministrisë dhe Fadil Lubeniqit për furnizim me pika intravenoze. Sidomos, në lidhje me pretendimet se z. Lubeniqi ka refuzuar t'i paguaj ryshfet H.F.. Kjo është akuza për të cilën, në fakt, H.F. është dënuar sipas pikës 8.
48. Po ashtu për pikën 2, gjykata ka vërtetuar se Bekim Deshishku i është ofruar një tender në vlerë prej 70.000€ për t'i tërhequr pretendimet¹². Bekim Deshishku ka deklaruar se Arbenita ka bërë këtë ofertë. Faton Çitaku e ka marrë vesh këtë informatë nga Bekimi menjëherë pas ngjarjeve dhe ka konfirmuar. Gjykata nuk ka dhënë ndonjë arsyetim se pse deklaratat e Bekim Deshishkut, Faton Çitakut dhe Ekrem Maliqit nuk janë të besueshme dhe nuk mjaftojnë për të vërtetuar përgjegjësinë penale të Tolajt dhe A.P.t, sipas pikës 2.
49. Kolegji nuk ka gjetur arsyetim në lidhje me pikën 3.1, pikën 10 dhe 12. Nga formulimi i dobët është kuptuar se ka pasur kundërthënie në mes deklaratave të dëshmitarëve. Mungesa e arsytimit i paraqet kolegjit vështirësi të mëdha në dhënien e udhëzimit adekuat për këto pika. Veç informimit mbi dëshmitë e dhëna nga disa dëshmitarë, aktgjykimi nuk jep ndonjë analizë në detaje për besueshmërinë dhe vlerën provuese të dëshmive të tyre. Kolegji është në dijeni se ka mospërputhje dhe kundërthënie ndërmjet dëshmitarëve, por ia vlen të ceket që sa herë shfaqen kundërthënie dhe mospërputhje për elementet përbërëse të veprës kriminale, pavarësisht a janë a nuk janë të arsyeshme, duhet të shpjegohen deri në

¹² Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, faqe 25

atë masë sa provat të mos vënë dyshim ekzistimin e këtyre elementeve. Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë asnjë vlerësim të deklaratave.

50. Kolegji konsideron se ankesa e PSRK-së lidhur me pikat nën 1.4, 1.5 dhe 11 është e pabazë. Kolegji konstaton se ankesa e avokatit të Tolajt është e pabazuar lidhur me pikën në 9, kurse ankesa e avokatit të Fejzajt tërësisht e pabazuar. Ndërsa për pikën nën 1.4 dhe 1.5 kolegji konstaton se këto vepra ndërlidhen me veprat tjera penale. Përshkrimi faktik i këtyre vepra nuk lë mundësi për trajtim të veçantë pasi që ato ndërlidhen me akuzat e shpjeguara më sipër. Zhvillimi i procesit të veçantë për to në fakt nënkupton krijimin e një mundësie të gjykimit të pandehurve dy herë për vepra të njëjta. Prandaj, kolegji konsideron se ankesa e PSRK-së është e pabazë. Për pikën nën 11, kolegji është i mendimit se prokuroi nuk ka mundur të paraqes prova se kthimi i Tolajt në punë përbën vepër penale. Vetëm pse Ministria e Shëndetësisë ka zbatuar një vendim të Gjykatës Supreme për kthimin e një shërbyesi civil në vendin e punës nuk përbën vepër penale. Se a ka qenë detyrë e kryeministrit apo ministrit të shëndetësisë ta kthej në punë është thelbësisht çështje administrative që del përtej suazave të shqyrtimit në këtë procedurë penale.
51. Siç kemi thënë më lartë, kolegji e gjen të pabazë edhe ankesën e avokatit të Tolajt lidhur me pikën 9. Nuk kontestohet se Tolajt nuk ka deklaruar tatimin e tij. Këtë avokati nuk e mohon. Fakti që i ka paguar tatimet më vonë, kjo nuk e liron atë nga përgjegjësia penale. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyetim adekuat për parashkrimin. Data e fillimit është 24 gusht 2010 kur janë deklaruar të hyrat. Sepse aktakuza është ngritë me 7 korrik 2012. Prandaj parashkrimi relativ është ndërprerë. Për këtë arsye kolegji nuk ka gjetur ndonjë shkelje të dispozitës së kodit penal.
52. Kolegji konstaton se edhe ankesa e avokatit të Fejzës është e pabazuar. Avokati ka deklaruar se nuk ka kuptim sipas pikës 8.2 të aktgjykimit që “ *në një datë të pacaktuar në 2011, Milaim Abdullahut i kanë thënë se duhej të jepte një pjesë të 10% nëse dëshironte të fitoj kontratë me Ministrinë e Shëndetësisë*”. Ka deklaruar se aktgjykimi nuk mbështetet

me ndonjë provë sepse z. Avdullahu nuk e ka përmendur 10% por “një shumë të caktuar parash”. Kolegji konstaton se ky argument nuk është meritore. Kolegji është i bindur se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të saktë ka vërtetuar se në nëntor 2010, H.F. ka pasur takim me Fadil Lubeniqi për vazhdimin e kontratës. Është vërtetuar edhe se në fillim të vitit 2011, H.F. është takuar me Milaim Abdullahu për të diskutuar për një kontratë me Ministrinë e Shëndetësisë. Këto takime janë vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Ç’është e vërteta, as mbrojtja nuk argumenton se takimet nuk kanë ndodhur. Kolegji konstaton se avokati nuk ka bërë ndonjë elaborim se në çfarë aspekti dispozitivi është në kundërtënie me deklaratat e cekura. Kolegji shpreh mendimin se mospërputhjet e vogla siç ka pretenduar mbrojtja për 10%-shin apo “një shumë e caktuar parash” nuk paraqesin shkelje esenciale që do ta bënin aktgjykimin të *pavlefshëm* dhe/ose kërkonin anulimin e tij nëse procedura, në përgjithësi, shikuar në tërësi, është zbatuar në aso mënyrë që nuk shfaq dyshim për saktësi. Ekzistimi i disa mospërputhje të vogla nuk e ngjall pretendimin për shkelje serioze të drejtave të pandehurit që mbrohen me ligjet aplikative. Gjykata nuk ka gjetur se shkeljet kanë përbërë cenim evident të ligjit. Kolegji është i bindur se gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar ka paraqitur fakte të vërtetuara me korrektësi dhe ka dhënë arsye të qarta dhe bindëse për vërtetimin e fakteve të lëndës. Prandaj nuk ka kundërtënie në dispozitiv të aktgjykimit as ndërmjet dispozitivit dhe arsyetimit. Sa i takon shkeljeve të supozuara të dispozitës së Kodit Penal, kolegji vëren se në këtë rast janë zbatuar dispozitat e dy kodeve penale. Në rast të ndonjë ndryshimi në ligjin e zbatuar në ndonjë lëndë para vendimit të plotfuqishëm, siç është rasti këtu, zbatohet ligji më i favorshëm për kryerësin. Duke krahasuar dispozitat e dy kodeve penale që lidhen me këtë rast, kolegji nuk gjen ndonjë ndryshim të veçantë ndërmjet dy kodeve që do të mund të ishin më të favorshme për të pandehurin. Për këtë arsye, kolegji nuk ka gjetur shkelje të dispozitave të Kodit Penal. Përkitazi me vendimin për dënimin e caktuar kundër H.F. , kolegji është i bindur se gjykata e shkallës së parë ka dhënë një vlerësim adekuat të rrethanave në mënyrë të plotë sipas ligjit. Duke pasur parasysh rrethanat specifike që ndërlidhen me rastin, mënyrën si është kryer krimi – modus operandi si edhe intensitetin e rrezikut shoqëror të veprës penale, gjykata nxjerr përfundimin se dënimi i caktuar është i drejtë dhe i ligjshëm, pra në përputhje me qëllimin e dënimit, siç parashihet me ligj.

53. Duke qenë se lënda kthehet në rigjykim për disa pika, ankesa e avokatit të Tolajt, përveç pikës 9 që u shtjelluar më herët, është jorelevante. Prandaj kolegji ka kufizime në shtjellimin e mëtejme të pikave tjera. Kolegji konstaton se situata e njëjtë vlen edhe për avokatin që përfaqëson Pajazitin dhe Parashtresën Shtesë në ankesën e parashtruar nga I.T..
54. Gjykata e Apelit gjithashtu ka kufizime edhe në dhënien e një mendimi për Urdhrin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me nr 302-2/08 të datës 29 prill 2008. Gjykata Themelore duhet të mbaj gjykim nga fillimi, me ç ‘rast të gjitha provat, bashkë me Urdhrin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, me nr 302-2/08 të datës 29 prill 2008, duhet të shqyrtohen siç parashihet në KPP.

KONKLUDIM

Gjykata e Apelit nuk kërkon t’i trajtoj të gjitha kundërthëniet dhe mungesat në aktgjykimin e gjykatës më të ulët. Ato që janë diskutuar *më lartë* mjaftojnë për ta vënë në dyshim qasjen e gjykatës më të ulët lidhur me prezantimin e gjetjeve dhe vlerësimin e provave.

Në bazë të asaj që u tha më lartë, Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT

PRISHTINË

PAKR 487/13

Kryetari i kolegjit

Piotr Bojarczuk

Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtës

Adnan Isufi,

Këshilltar ligjor i EULEX-it

Anëtarët e kolegjit

Roman Raab

Gjyqtar i EULEX-it

Xhevdet Abazi

Gjyqtar i Gjykatës së Apelit